

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Nr. 02-61/22-07  
Prishtinë, më 27 shtator 2007  
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

**Kryesuesi** konstatoi se në seancë janë të pranishëm 72 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Seanca i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj;
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin civil;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin;
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për parqet nacionale dhe
13. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit.

Në fillim të seancës, **kryesuesi** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, nuk ka pasur asnjë propozim me shkrim për ta amendamentuar rendin e ditës.

Për fjalë u paraqit deputeti **Bajrush Xhemajli**, i cili kërkoi që, si çështje e ngutshme, Kuvendi të debatojë për vendimin e P SSP-së për ndarjen e një ( 1) milion € AKM-së pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës.

Deputeti **Xhevat Bislimi** kërkoi që Kuvendi të diskutojë dhe ta miratojë planin e veprimit pas 10 dhjetorit 2007.

**Kryesuesi** i njoftoi të pranishmit se Ministria e Punëve të Brendshme e kishte përgatitur një Informatë për gjendjen e sigurisë në Mitrovicë, por ajo nuk ishte radhitur për seancën e sotme, ngase ishte dorëzuar dje pasdite.

Seanca i vazhdoi punimet sipas rendit të propozuar të ditës.

#### **1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007**

Procesverbali i seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007 u miratua pa vërejtje.

#### **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Hydajet Hyseni** u parashtrroi pyetje Qeverisë së Kosovës dhe ministrit të Pushtetit Lokal lidhur me krijimin e kushteve: të repetitorëve për pranimin e sinjalit televiziv të Televizionit Publik; për lidhjet telefonike dhe rrugët për banorët e Restelicës me rrethinë.

Zëvendëskryeministri **Lutfu Haziri** dhe ministri **Sadik Idriz** iu përgjigjen pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me vazhdimin e veprimtarive në ndërmarrjet e privatizuara dhe kthimin e punëtorëve në vendet e punës.

Ministri **Bujar Dugolli** nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetit Kelmendi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministres së Shërbimeve Publike lidhur me regjistrimin e popullsisë në Kosovë.

Ministrja **Melihate Tërmkolli** iu përgjigjur pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Fetah Berisha** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për mbrojtjen e vendit "Verrat e Lukës", ku është mbajtur Kuvendi i Pajtimit të Gjaqeve, sipas Ligjit për trashëgiminë kulturore.